



Departamenti i Gjuhës Italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës (Shqipëri) dhe Instituti Italian i Kulturës organizojnë Konferencën Ndërkombëtare me titull:

## ***Përkthimi dhe receptimi i letërsisë italiane në Shqipëri***

Konferenca do të mbahet më **17 tetor 2024** gjatë edicionit të XXIV të Javës së Gjuhës Italiane në botë dhe do të zhvillohet fizikisht pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës (Shqipëri) dhe online në platformën Google Meet.

Objekti i konferencës është të nxisë një perspektivë studimore mbi përkthimin e letërsisë italiane në Shqipëri. Kumesat do të synojnë të skicojnë një hartë të përkthimeve përmes analizës së të dhënave që kanë të bëjnë me autorët italianë të përkthyer, titujt e përzgjedhur për përkthim, datat e botimit, shtëpitë botuese, llojet e tekstit dhe recensionet e mundshme.

Një fushë e dytë e kërkimit do të jetë perspektiva teorike, e cila do të përqendrohet në kompleksitetin e përkthimit letrar. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet analizës krahasuese midis veprave origjinale dhe teksteve të përkthyer, duke u fokusuar në çështje të tilla si humbja e nuancave gjuhësore dhe kulturore, vështirësitë në ruajtjen e stilit të autorit, të konotacioneve kulturore, të poetikës dhe ritmit, si dhe sfida e përkthimit të dialekteve. Do të mund të hulumtohen, gjithashtu, aspekte që kanë të bëjnë me ripërkthimin e veprave të ndryshme, duke dëshmuar, ndër të tjera, interesin e lexuesit shqiptar për letërsinë italiane.

### **Data të rëndësishme:**

- |                        |   |
|------------------------|---|
| <b>8 shtator 2024</b>  | Afati i fundit për dërgimin e përmbledhjeve (150 – 200 fjalë) |
| <b>15 shtator 2024</b> | Njoftimi për propozimet e pranuar                             |
| <b>17 shtator 2024</b> | Konferenca Ndërkombëtare                                      |

**Gjuhët zyrtare** të konferencës do të jenë *gjuha italiane* dhe *gjuha shqipe*.

Të gjitha punimet e pranuar do të botohen në *Aktet e Konferencës*.

**Adresa e postës elektronike** ku mund të dërgohen përmbledhjet, punimet e plota dhe ku mund të merren më shumë informacione është: [departamenti.italisht@unitir.edu.al](mailto:departamenti.italisht@unitir.edu.al)

### **Komiteti shkencor:**

- Prof. Giuseppina Turano (Universiteti Ca' Foscari Venezia)
- Prof. Asoc. Dr. Mirela Papa (Universiteti i Tiranës)
- Prof. Asoc. Dr. Renata Martini Kristo (Universiteti i Tiranës)
- Prof. Brunilda Dashi (Universiteti i Romës "La Sapienza")
- Prof. Dr. Irena Lama (Universiteti i Tiranës)
- Prof. Dr. Klodeta Dibra (Universiteti i Tiranës)
- Prof. Angelo Favaro (Universiteti i Romës "Tor Vergata")
- Prof. Asoc. Dr. Alma Hafizi (Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi")
- Prof. Asoc. Dr. Alva Dani (Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi")

### **Komiteti organizativ:**

- Dott. Alessandro Ruggera (Drejtor i Institutit Italian të Kulturës, Tiranë)
- Prof. Asoc. Dr. Mirela Papa (Departamenti i Gjuhës Italiane, Universiteti i Tiranës)
- Prof.ssa Daniela Silvano (lektore MAECI)
- Prof. Dr. Irena Lama (Departamenti i Gjuhës Italiane, Universiteti i Tiranës)